

## Komuna e Suharekës/Suva Reka

### **Rexhep (Rrahman) Ahmeti**

(1940, shqiptar nga Prizreni/Prizren, pesë fëmijë)

Rexhepi ka lindur në Maqitevë/Maçitevo, ndërkaq me familje jetonin në Prizren, në afërsi të tregut. U zhduk më **10.04.1998** në fshatin **Reshtan/Raštane**. Familja nuk ka siguruar kurrfarë njohurish për fatin e tij deri më sot. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është sistemuar në lëndën me numër BLG-803906-01.

**Burimet:** deklarata S.H, FDH-36853; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### **Saša (Dragi) Jovanović**

(15.05.1972, serb nga Suhareka/Suva Reka, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Pas përfundimit të shkollës së mesme, Saša e ka kryer shkollën për oficerë rezervë dhe trajnimin për oficer policie. Nga viti 1993, punonte në Stacionin Policor në Suharekë/Suva Reka. Në mbrëmje të datës **29.04.1998**, rreth orës 23:00, Saša me disa kolegë gjendeshin në postbllokun policor në fshatin **Duhël/Dulje**, në rrugë Suharekë/Suva Reka – Shtime/Štimlje. Pjesëtarë të UÇK-së e kanë sulmuar postbllokun dhe, me këtë rast, Saša u plagos rëndë. Ka dhënë shpirt në rrugë për në spitalin e Prizrenit/Prizren. Familjarët e kanë varrosur në varrezat e vendlindjes në Hum, te Nishi.

**Burimet:** deklarata S.J, FDH-30752; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, II, 692; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 146, FDH-23857; SMIP, *Teroristički...*, III, 382, 933; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 32.

### **Latife (Eqrem Rrahmani) Kololli**

(21.03.1953, shqiptare nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, amvise, gjashtë fëmijë)

### **Rrushe (Tahir) Kololli**

(5.02.1979, shqiptare nga Budakova/Budakovo, komuna e Suharekës/Suva Reka, amvise, e martuar)

Latifja me burrin Tahirin dhe fëmijët jetonin në Budakovë/Budakovo. Në muajin **qershor të vitit 1998**, për një vizitë tek ata erdhi vajza Rrushe, e cila me familje jetonin në fshatin Bllacë/Blace. Rrushja ishte shtatzëne. Pas disa ditësh, Latifja me Rrushen shkuan për një vizitë te vajza e madhe e Latifes, Sadija, e cila ishte e martuar në fshatin **Maqitevë/Maçitevo**. Nga ajo ditë nuk ka asnjë gjurmë për fatin e Latifes dhe Rrushes. Trupat e tyre të pajetë u gjendën më 23.08.1998 te fshati Topliçan/Topliçane. I kishin plagë të shumta nëpër trup, që ishin të shaktuara me mjete të mprehta dhe me teh të topitur. Pushteti serb i ka varrosur të ëmën dhe të bijën në varrezat e Shirokës/Široko. Vetëm në vitin 2000, familjarët kanë mësuar për vendin ku ishin varrosur Latifja dhe Rrushja. Mbetjet mortore të Latifes janë rivarrosur në varrezat e Budakovës/Budakovo më 10.07.2003. Familja ende nuk i ka pranuar mbetjet mortore të Rrushes.

**Burimet:** deklarata K.K, FDH-32546; deklarata A.H, FDH-10112; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex. 6D00803, FDH-31372; AIS, *Zona...*, 58, FDH-16913; SMIP, *Teroristički...*, III, 108, 912; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Mother*